



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2020:126561

Datë: 28.01.2026

Numri i dokumentit: 08382270

Kom.Dh.Shk.II.nr.404/2025

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar i kolegjit, Vlora Pacolli-Rexhepi dhe Fisnik Nuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit “Mast-Jagermaister SE” me seli në Gjermani, të cilën me autorizim e përfaqëson Agron Selimaj, avokat nga Prishtina, kundër të paditurve 1. “Infinnity XK” Sh.P.K., me nr. të biznesit 810057241 dhe me seli në Prishtinë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga Florin Lata, avokat nga Prishtina, si dhe 2. “B&M” Sh.P.K. me nr. të biznesit 810842189 dhe me seli në Prishtinë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga Liman Musa, avokat nga Ferizaj, me objekt kontesti shkelje e markës tregtare dhe kompensim dëmi, duke vendosur lidhur me ankesat e paditësit dhe të paditurit të dytë, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KE.nr.1047/2022, të datës 28.01.2025, me datë 22.01.2026, mori këtë;

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar ankesa e paditësit “Mast-Jagermaister SE” me seli në Gjermani, NDRYSHOHET pika VIII e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KE.nr.1047/2022, të datës 28.01.2025, ashtu që gjykohet si në vijim: DETYROHEN të paditurat që në mënyrë solidare t’ia paguajnë paditësit shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 2,327€, në afat prej shtatë (7) ditësh nga marrja e këtij aktgjykimi.
- II. REFUZOHET ankesa e paditësit “Mast-Jagermaister SE” me seli në Gjermani lidhur me pjesët tjera të goditura të aktgjykimit, dhe refuzohet në tërësi ankesa e të paditurës së dytë B&M SHPK, me seli në Prishtinë, ashtu që aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KE.nr.1047/2022, të datës 28.01.2025, në pikën I, II, III, IV, V, VI, VII dhe IX të dispozitivit VËRTETOHET,

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar KE.nr.1047/2022, i datës 28.01.2025 Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vepruar si gjykatë e shkallës së parë, ka vendosur si në vijim:

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Mast-Jagermaister SE” me seli në Gjermani ashtu që:

a) VËRTETOHET se i padituri i parë “Infinnity XK” Sh.P.K., përmes importimit pa autorizim të 1,800.00 shisheve të pijes alkoolike “Jagermaister”, ka shkelur markën tregtare të paditësit të regjistruar pranë Agjencisë për Pronësi Industriale sipas vendimeve nr. 19113, nr. 19114, nr. 19117 dhe nr. 19118.

b) VËRTETOHET se i padituri i dytë “B&M” Sh.P.K. përmes importimit të pa autorizim të 4,398.00 shisheve të pijes alkoolike “Jagermaister”, ka shkelur markën tregtare të paditësit të regjistruar pranë Agjencisë për Pronësi Industriale sipas vendimeve nr. 19113, nr.19114, nr. 19117 dhe nr. 19118.

II. DETYROHET i padituri i dytë “B&M” Sh.P.K.” që në emër të fitimit të padrejtë të realizuar nga shkelja si në pikën I (b) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, si fitim i realizuar pa bazë, t’ia paguaj paditësit shumën prej 2,090.40 EUR, me kamatë ligjore prej 8% nga data e paraqitjes së kërkesëpadiës më 23.01.2025 e deri në pagesën definitive, në afat prej shtatë (7) ditësh nga plotëfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

III. IU NDALOHET të paditurve që në të ardhmen të ndërmarrin çfarëdo veprimi me të cilin mund të shkelen të drejtat e pronësisë intelektuale të paditësit, në çfarëdo mënyrë përfshirë importimin, eksportimin dhe vendosjen në treg të produkteve që përbëjnë shkelje të markës tregtare të paditësit.

IV. OBLIGOHEN të paditurit që me shpenzimet e tyre ta publikojnë në tërësi këtë aktgjykim në të paktën tre (3) medime të Republikës së Kosovës, në afat prej shtatë (7) ditësh nga plotëfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

V. REFUZOHET si e pabazuar pjesa e kërkesëpadiës së paditësit “Mast-Jagermaister SE” me të cilin ka kërkuar që të detyrohet i padituri i dytë “B&M” Sh.P.K., që në emër të fitimit të padrejtë të realizuar nga shkelja e markës tregtare të paditësit të paguaj edhe shumën mbi vlerën e gjykuar si në dispozitivin II të këtij aktgjykimi, dhe atë në vlerë prej 768.30 EUR, për shkak të parashkrimit të kërkesëpadiës.

VI. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “Mast-Jagermaister SE” me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i parë Infinnity XK” Sh.P.K., që në emër të fitimit të padrejtë të realizuar nga shkelja si në pikën I (a) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t’ia paguaj paditësit shumën prej 1,170.00 EUR, me kamatë ligjore prej 8% nga data e parashkrimit të padisë më 23.01.2020 e deri në pagesën definitive, për shkak të parashkrimit të kërkesëpadiës.

VII. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit me të cilin ka kërkuar që të obligohen të paditurit që me shpenzimet e tij t’i shkatërrojnë të gjitha mallrat si në pikën I

të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në afat prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

VIII. DETYROHEN të paditurit që në mënyrë solidare t'ia paguajnë paditësit shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1,229.80 EUR (njëmijë e dyqind e njëzet e nëntë euro e tetëdhjetë euro cent), në afat prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

IX. MBETET në fuqi masa siguruese e lëshuar me aktvendimin IV.EK.C.nr. 472/20 e datës 22.12.2022, deri në plotëfuqishmërinë e këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar, me të cilën e ka goditur aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në pikën II, V, VI dhe VIII, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa e paditësit ashtu që të ndryshohen pikat II, V, VI dhe VIII të aktgjykimit KE.nr.1047 dt.28.01.2025 ashtu që në raport me këto pika të dispozitivit të aktgjykimit të aprovohet kërkesëpadia në tërësi si e bazuar.

Kundër aktgjykimit ankesë ka parashtruar edhe i padituri i dytë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurit të dytë dhe të anulohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194, 208 dhe 209 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Ankesa e të paditurës së dytë është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Paditësi “Mast-Jagermaister SE” me seli në Gjermani, përmes të autorizuarit të tij, me datë 02.10.2020 ka paraqitur padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, me të cilën ka kërkuar që të konstatohet se të paditurit 1. “Infinnity XK” Sh.P.K., 2. N.T. “Beni” si dhe 3. “B&M” Sh.P.K., përmes importimit të pijeve alkoolike që bartin markën tregtare të paditësit “Jagermaister”, kanë shkelur markën tregtare të mbrojtur të paditësit sipas vendimeve nr. 19113, 19114, 19117 dhe 19118. Me padi ka kërkuar që të paditurit të urdhërohen t'i shkatërrojnë të gjitha mallrat që shkelin markën tregtare të paditësit, që të njëjtëve t'iu ndalohet çdo aktivitet që do ta shkelte markën tregtare të paditësit të regjistruar në Kosovë, që të njëjtit të detyrohen që ta publikojnë aktgjykimin në të paktën tre (3) medime në Kosovë dhe të detyrohen të njëjtit që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës kontestimore.

Në padi dhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor, paditësi ka theksuar se i padituri i parë “Inffinity XK” Sh.P.K., pa autorizimin apo pëlqimin paraprak të pronarit të markës tregtare importon në Kosovë 1800 shishe (1 litër) të pijes alkoolike Jagermaister. I padituri i dytë B&M Sh.P.K., pa autorizimin apo pëlqimin paraprak të paditësit Mast –Jagermaister, me datën 10.11.2019 importon në Kosovë 300 shishe (0.7L) të pijes Jagermaister, me datën 04.05.2020 importon 300 shishe (0.7L) të pijes Jagermaster, me datën 14.05.2020 importon 858 shishe (0.7L) dhe me datën 06.09.2020 importon gjithashtu 858 shishe (0.7L) të pijes alkoolike Jagermaister. Përsëri i padituri i dytë B&M pa autorizimin dhe pëlqimin paraprak të paditësit ka provuar të importon dhe vendos në tregun e Kosovës në mënyrë të kundërligjshme edhe 420 shishe (0.7L) të pijes Jagermaister, por kësaj radhe ndalohen nga Dogana e Kosovës dhe kjo sasi nuk lejohet për qarkullim të lirë në Tregun e Kosovës. Ka theksuar se me këto veprime, paditëses i është shkaktuar dëm në formën e fitimit të humbur, kjo pasi që fitimi të cilin të paditurit e kanë realizuar nga shitja e produkteve të paditësit pa pëlqim, është fitim që duhet t’i takoj paditësit. Në shqyrtimin gjyqësor paditësi ka bërë precizimin e kërkesëpadisë duke kërkuar nga gjykata që të vërtetohet se i padituri i parë “Inffinity XK” Sh.P.K., përmes importimit pa autorizim të 1,800.00 shisheve (1L) të pijës alkoolike “Jagermaister”, dhe i padituri i dytë “B&M” Sh.P.K. përmes importimit të pa autorizim të 4,398.00 shisheve të pijës alkoolike “Jagermaister”, kanë shkelur markën tregtare të paditësit sipas vendimeve nr. 19113, 19114, 19117 dhe 19118. Tutje ka kërkuar që të detyrohet i padituri i parë Inffinity XK” Sh.P.K., që në emër të dëmit material të në formë të fitimit të humbur të shkaktuar për paditësin nga shkelja e markës tregtare t’ia paguaj paditësit shumën prej 1,170.00 EUR, ndërsa i padituri i dytë “B&M” Sh.P.K.” shumën prej 2,858.70 EUR, me kamatë ligjore prej 8% nga data e parashtrimit të padisë më 23.01.2020 e deri në pagesën definitive. Tutje ka kërkuar që të paditurit të urdhërohen t’i shkatërrojnë të gjitha mallrat që shkelin markën tregtare të paditësit, që të njëjtëve t’iu ndalohet çdo aktivitet që do ta shkelte markën tregtare të paditësit të regjistruar në Kosovë, që të njëjtë të detyrohen që ta publikojnë aktgjykimin në të paktën tre (3) medime në Kosovë dhe të detyrohen të njëjtë që t’i paguajnë shpenzimet e procedurës kontestimore.

Në shqyrtimin kryesor të datës 23.01.2025, paditësi ka tërhequr padinë në raport me të paditurin e dytë N.T. “Beni” me seli në Prishtinë dhe për të cilën tërheqje, gjykata ka vendosur me aktvendim procedural përgjatë kësaj seance.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, si në dispozitivin e aktgjykimit. Deri te ky vlerësim gjykata e shkallës së parë ka ardhur pasi që ka konstatuar se paditësi, duke qenë bartës i të drejtës në markën tregtare “Jagermaister”, kishte dhënë të drejtën ekskluzive vetëm subjektit N.T. “Kos Trade” me seli në Kosovë për të vendosur në tregun e Republikës së Kosovës produktet që bartin markën tregtare të paditësit. Përkundër kësaj, i padituri i parë dhe i padituri i dytë, kanë importuar produktet e paditësit të mbrojtura nën markën tregtare “JagerMeister” pa pëlqimin e paditësit dhe pa autorizimin e tij, importime këto të cilat nuk kanë qenë kontestues as nga vet të paditurit, e të cilat janë vërtetuar edhe nga ekspertiza financiare e marrë si provë në këtë procedurë, dhe nga e cila është konstatuar fakti se përgjatë vitit 2019 dhe 2020, i padituri i parë ka importuar gjithsej 1800 shishe “Jagermaister” ndërsa i padituri i dytë ka importuar gjithsej 4398 shishe “Jagermaister”. Me këto veprime, të paditurit kanë shkelur një nga të drejtat kryesore që derivojnë nga mbrojtja e të drejtës

në markë tregtare, atë të vënies në treg të mallrave që bartin markën tregtare të paditësit vetëm me pëlqimin dhe me autorizimin e tij, shkelje kjo e cila i jep të drejtë paditësit që të kërkoj mbrojtje gjyqësore bazuar në nenin 8, par. 2, nën-par. 2.2 të LMT-së i cili përcakton se pronari i markës gjithashtu mund të ndalojë këto veprime të kryera nga palët e treta pa pëlqimin e tij: “2.2. *hedhja e mallrave në treg, ofrimi i tyre për shitje*”.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, para. 2, nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Dhomat e shkallës së dytë gjejnë se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore ngase gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për vendosjen përkitazi me faktet vendimtare. Sipas vlerësimit të Kolegjit, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, duke dhënë arsye të qarta për faktet vendimtare.

Pretendimet ankimore për shkelje esenciale të dispozitave, referuar të provuarit dhe fakteve vendimtare, Kolegji i gjen të pabazuara ngase në ankesë nuk ka asnjë pretendim konkret lidhur me ndonjë shkelje procedurale e cila do të kishte pasojë për shkeljet thelbësore si pasojë e së cilës do të vinte tek kushtet për prishjen e aktgjykimit. Përkundër kësaj, Kolegji i shqyrtoi pretendimet lidhur me të provuarit dhe arsyet e aktgjykimit, por gjeti se në çështjen konkrete gjykata e shkallës së parë drejtë i ka vlerësuar provat dhe me të drejtë ka ardhur tek konstatimi i gjendjes faktike, duke dhënë arsye jo vetëm për secilën nga provat, por ka dhënë arsye edhe lidhur me pjesën refuzuese të cilën e atakon paditësi me ankesë.

Edhe pse i autorizuari i të paditurës ka ngritur pretendime të përgjithësuara rreth shkeljeve esenciale, Gjykata e shkallës së dytë, sa i përket pretendimeve ankimore të paditurit në lidhje me shkeljet thelbësore të dispozitave procedurale, nga Neni 182 par.1 pika n) gjeti se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje të nenit 182, para. 2, pika n) të LPK-së, sepse ai nuk përmban asnjë të metë të paraparë në këtë dispozitë ligjore. Aktgjykimi i ankimuar mund të ekzaminohet, dhe ka dispozitiv të kuptueshëm që nuk është në kontradiktë me vetveten. Krahës këtyre, aktgjykimi i ankimuar përmban arsyetime të qarta të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat kanë rezultuar me dispozitivin refuzues lidhur me bazën juridike të vërtetuar mbi prova. Po ashtu, në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar Gjykata e shkallës së parë në mënyrë shprehimore ka zbatuar dispozitat e së drejtës materiale nëpërmjet të cilave ka ardhur tek përfundimi se me provat e dhëna nuk është formuar baza juridike për të aprovuar kërkesëpadinë.

Sa i përket pretendimeve për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Kolegji vlerëson se nuk qëndron pretendimi me ankesë, se data respektivisht koha e parashtrimit të

kërkesës për shpërblimin e dëmit material për dëmin material duhet llogaritur nga rastin e nxjerrjes së aktvendimit për nxjerrjen e provës me ekspertizë. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë ndonëse me të drejtë ka aprovuar propozimin për nxjerrjen e ekspertizës të kërkuar nga paditësi, si mundësi për nxjerrjen e e mjetit provues, megjithatë parashkrimin drejtë e ka llogaritur nga koha e parashtrimit të kërkesës së re materialo-juridike, e cila i nënshtrohet afateve të parashkrimit nga koha e paraqitjes së kërkesës në procedurë. Pretendimet tjera ankimore lidhur me afatet procedurale të ekspertit, kohën e dhënies së mendimit dhe faktorët tjerë që kanë ndikuar në rrjedhën e procedurës, Kolegji nuk i mori parasysh ngase të njëjtat nuk janë në ndikim në të drejtën e paditësit për të parashtruar kërkesat kompensuese të cilat i takojnë. Asnjë rrethanë procedurale, qoftë ekspertiza apo tjetër nuk e ka penguar palën paditëse për të parashtruar me kohë kërkesat e veta, dhe as nuk janë arsye ligjore për të evituar përfshirjen e kërkesave të tilla në parashkrim.

Pretendimi i paditësit me ankesë i cili i referohet zbatimit të gabuar të drejtës materiale për pjesën e refuzuar, e me të cilën në anën tjetër pretendohen shkeljet e Nenit 257 par.1 i LPK-së, është i paqëndrueshëm. Neni 257 i LPK-së parasheh shprehimisht veprimet procedurale të cilat paraqesin ndryshim të padisë në kuptim objektiv të çështjes. Këtu përfshihet edhe kërkesa e re, apo kërkesa tjetër nga ajo ekzistuese – që nënkupton çfarëdo kërkesë në raport me ato të cilat pala i ka paraqitur me padinë fillestare. Pavarësisht përdorimit të termave, siç është precizimi në rastin konkret, është evidente se paditësi ka parashtruar kërkesë të cilën nuk e kishte përfshirë në padinë ekzistuese. Rrjedhimisht, nuk qëndron pohimi i të autorizuarit të paditësit se data e parashtrimit duhet të merret ajo e caktimit të ekspertizës, ngase një referencë e tillë ka të bëjë me nxjerrjen e mjetit provues dhe jo me ndryshimin e kërkesës.

Sa i takon shpenzimeve të procedurës Kolegji çmon se janë të bazuara theksimet në ankesën e paditësit se në këtë çështje juridike paditësi ka përfaqësuar në pesë seanca gjyqësore dhe se me faktin se kemi të bëjmë me konteste gjyqësore me element të huaj, të njëjtit i takon tarifa me rritje prej 100% sa i takon shpenzimeve gjyqësore në emër të përfaqësimit dhe veprimeve procedurale përfshirë padinë. Andaj, Kolegji vlerëson se në rastin konkret paditësit duhet t'i njihen shpenzimet për padi në shumën 117 euro, përfaqësim në pesë seanca nga 152.10 euro, shuma prej 760.50 euro. Për të dy këto kategori të shpenzimeve, pra për përpilimin e padisë dhe përfaqësim, sipas Numri Tarifor 7 par.3 të TOAK, palës paditëse i takon rritja prej 100%. Pra shuma prej 234 euro për padi dhe shuma prej 1,521 euro për përfaqësim, e po ashtu edhe shuma prej 72 euro për taksën gjyqësore dhe 500 euro për ekspertizën financiare, të gjitha në shumë prej 2,327 euro. Andaj, Kolegji vendosi si në pikën I të dispozitivit.

Sa i takon pretendimeve ankimore të paditurit të dytë se duhet paguar shuma prej 2090.40 euro për mallin i cili gjendet në Doganë, Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë mjaftueshëm ka arsyetuar faktet lidhur me vendosjen kur ka theksuar se Në anën tjetër, nga ekspertiza financiare e datës 01.10.2024 dhe plotësimi i saj i datës 06.12.2024, gjykata vërtetoi fakti se i padituri i dytë, nga katër (4) importimet e produkteve që bartin markën tregtare të paditësit të realizuara në periudhën kohore nga data 05.04.2020 e deri më datë 10.08.2020, ka realizuar fitim të padrejtë në vlerë prej 2,090.40 EUR. Duke qenë se është provuar se për këto katër importe i padituri i dytë kishte realizuar profit, Kolegji vlerëson se fitimin e realizuar në emër të shitjes së

produkteve të importuara në periudhën kohore data 05.04.2020 e deri më datë 10.08.2020, e që mbajnë markën tregtare të paditësit “Jagermaister” ta kompensoj tek paditësi në shumën prej 2,090.40 EUR.

Pretendimet ankimore të paditurit të dytë se malli gjendet në depo doganore dhe nuk ka dalë në treg është i paqëndrueshëm ngase gjykata me provat e administruara ka arritur të provojë se me parashtrësën e Doganës nr. ref. R56217 i datës 18.09.2020 përmes komunikimit elektronik të datës 21.09.2020, Dogana e Kosovës ka njoftuar paditësin lidhur me ndalimin e mallrave që dyshohen se shkelin markën tregtare të paditësit, dhe atë 420 copë pije alkoolike JagerMeister (0.7L), duke njoftuar të njëjtin se importuesi B&M Sh.P.K., nuk ka dhënë pëlqimin për shkatërrim. Si rrjedhojë është vërtetuar se këto mallra kanë qenë të ndaluara nga Dogana, por jo edhe mallrat të cilat i padituri i dytë B&M Sh.P.K., ka realizuar nëntë (9) importime të produkteve që bartin markën tregtare të paditësit pa pëlqimin e tij. Këto fakte i ka verifikuar edhe eksperti financiar i cili ka konstatuar se nga Deklaratat Unike Doganore të siguruar zyrtarisht nga Dogana e Kosovës, rezulton se i padituri i dytë “B&M” Sh.P.K., ka importuar në territorin e Republikës së Kosovës gjithsej 4398 shishe “Jager Maister” përgjatë periudhës kohore nga data 03.10.2019 e deri më datë 10.08.2020.

Kolegji gjen se i padituri në asnjë fazë të procedurës nuk e ka ngritur pretendimin se mallrat janë në depo doganore dhe këtë nuk e dëshmon me asnjë provë as me ankesë. Për më tepër, nga provat e administruara, respektivisht nga komunikimi elektronik i dt. 10.11.2020 nga Dogana e Kosovës ishte konfirmuar se mallrat ishin lëshuar nga mbikëqyrja doganore. Së këndejmi, mbesin të pambështetura në prova pretendimet e të paditurit të dytë se malli ka mbetur në depo Doganore.

Në lidhje me faktin se malli nuk është importuar si mall fals por është mall origjinal, për Kolegjin nuk paraqet pretendim ankimor të bazuar për të vendosur ndryshe. Kjo për faktin se me Nenin 8 të LMT-së në fuqi pronari i markës tregtare gëzon mbrojtje duke iu mundësuar edhe e drejta e ndalimit të vendosë mallin me markën e mbrojtur, përfshirë këtu importin, transitin etj. Pra është evident fakti se nuk nënkupton medoemos se paditësi ka pasur të drejtë të gëzojë mbrojtje vetëm me faktin e vendosjes së produktit në treg apo kryerjen e importit por edhe ndalimin para se produkti të importohet. Rrjedhimisht, pretendimet ankimore të paditurës se malli është ndaluar në kufi para importimit, nën pretekstin se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar “vënien në qarkullim të produkteve” nuk ndryshon gjendjen faktike e as nuk i jep të drejtë të paditurës në një vendim ndryshe. Sipas Kolegjit, aspektet procedurale të mënyrës së vënies së produktit në treg, qoftë përmes importit apo deri në fazën e importit nuk bëjnë ndryshim në gëzimin e të drejtave absolute të markave tregtare.

Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, ngase bazuar në provat përkatëse të lëndës ka vlerësuar se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të të paditurit lidhur me konstatimin e gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë për faktin se në mënyrë të pakontestueshme është vërtetuar se i padituri në mënyrë të paautorizuar ka bërë futjen e mallit në fjalë në territorin e Republikës së Kosovës,

i cili mall ka përmbajtur në vete markën tregtare të paditësit të regjistruar në Republikën e Kosovës. Si rrjedhojë e këtij veprimi, i padituri ka shkelur të drejtën e markës tregtare të paditësit.

Sipas Nenit 8 të Ligjit Nr. 04/L-026 Për Markat Tregtare (LMT), i aplikueshëm në rastin konkret, të drejtat nga markat tregtare konsiderohen të drejta pronësore dhe të njëjtat përbëjnë të drejta absolute. Kjo nënkupton se të gjitha palët e treta obligohen që të përmbahen nga përdorimi i paautorizuar i markës tregtare të regjistruar. Titullar i markës tregtare mund t'i ndalojë palët e treta që pa pëlqimin e tij të përdorin shenjë identike ose të ngjashme për mallrat apo shërbimet të llojit të njëjtë ose të ngjashme. Me regjistrimin e një marke të caktuar, bartësi i markës tregtare fiton të drejtën ekskluzive mbi markën tregtare.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovojnë edhe Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale .

Nga sa u tha më lartë, Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 para. 1, pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë,
Kom.Dh.Shk.II.nr. 404/2025, me datë 22.01.2026

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova